



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
ZËVENDËSMINISTRI

Nr. 1706 / Prot. 3

Tiranë, më 14/10 /2020

URDHËR

Nr. 577, Datë 14.10 2020

“PËR

**NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË URDHRIN NR. 266/1, DATË 01.09.2020,
PËR MARRJEN E MASAVE TË VEÇANTA NGA KOMISIONET E VLERËSIMIT TË
AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE INVALIDËVE TË PUNËS PËR PARANDALIMIN E
PËRHAPJES SË INFEKSIONIT TË SHKAKTUAR NGA COVID-19”**

Në mbështetje të nenit 116, pika 3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr. 10107 datë 30.03.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 7 të Ligjit Nr. 57/2019 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, Ligjit Nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjit Nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Komitetit të Përkohshëm për infeksionin e përhapur nga Coronavirusi i ri”, si edhe Udhëzimit të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

1. Pika 2 e Urdhrit Nr. 266/1, datë 01.09.2020, i ndryshuar, riformulohet si më poshtë:

“2. Tejkalimi i afateve të vlerësimit/rivlerësimit të aftësisë së kufizuar, gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, të përcaktuar në Vendimin nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës personal”, i ndryshuar, nuk përbën shkak për ndërprerjen e pagesave të aftësisë së kufizuar”, për përfituesit të cilëve iu ka përfunduar afati i përfitimit sipas vendimit të komisionit. Trajtimi me pagesë bëhet deri në momentin e rikomisionimit të tyre.

2. Pas pikës 7 të Urdhrit Nr. 266/1, datë 01.09.2020, i ndryshuar, shtohen pikat 7.1 dhe 7.2 me këtë përmbajtje:

“7.1. Përjashtimisht gjatë periudhës së epidemisë së shkaktuar nga Covid-19 paraqitja e personave në komisionin e nivelit të parë, sipas pikave 1.1 dhe 1.2, të Kreut II të Vendimit Nr. 182, datë 26.2.2020, “Për përcaktimin e masës, të kriterëve, procedurave e dokumentacionit për vlerësimin dhe përfitimin e pagesës për personat me aftësi të kufizuara, si dhe të ndihmës

personal”, i ndryshuar, pikave 2.1 dhe 2.2 të Udhëzimit Nr. 2365, datë 26.11.2008, “Mbi zbatimin e vendimit nr. 277, datë 18.06.1997, “Për përfitimet nga statusi i të verbrit”, i ndryshuar, realizohet me komisionin, personalisht përmes platformave online dhe në prani të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (mjek), në vendbanimin e personit.

7.2 Paraqitja në KMCAP Epror bëhet me prezencën fizike të personit. Vetëm në raste të veçanta kur gjendja shëndetësore e rënduar është e argumentuar nga mjeku specialist përkatës, së bashku me arsyen e pamundësisë së paraqitjes në komision, si edhe kur KMCAP Epror gjykon që paraqitja fizike është e pamundur, procedura e vlerësimit bëhet përmes platformave online, në prezencë të përfaqësuesit të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror (mjek), ose me prezencën e anëtarit/ve të Komisionit Epror, në vendbanimin e personit.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtorja e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror. dhe anëtarët e KMCAP/ KMPV të nivelit të parë dhe KMCAP Epror. ✓

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

